

**AKT- THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“LA CAFFETTERIA” shpk**

Ne Durres, sot me date, 07/01/2021 (dymije e njezet e nje), me cilësinë e “Ortakut themelues” - Z. Serxhio Mezi, madhor, dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar.

me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij Akti Themelimi, nepermjet te cilit deklarom se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregjetaret dhe shoqerite tregjetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijom shoqerine tregjetare, me pergjegjesi te kufizuar, **“LA CAFFETTERIA”** shpk

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

**Shoqeria “LA CAFFETTERIA” shpk**

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“LA CAFFETTERIA”** shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga Z. Serxhio Mezi, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregjetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te Shoqerise.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqeria e ka selin në:

**Lagjja nr. 4, Rruga Egnatia, njesia me nr. pasurie 4/175-N2 zona kadastrale 8514 Durres**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Assamblese se ortakeve.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

Bar –kafe.

## Neni 5

### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## KREU II

### Kapitali

## Neni 6

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 50 000 (pesedhjet mijë) lekë,

Pjesemarrja themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- 1- Ortaku themlues Serxhio Mezi : zoterues i I ( nje ) kuote me vlere te pergjithshme 50,000 leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Kapitali themeltare eshte i nenshkruar plotësisht nga ortaket themelues ne masën 100%

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .

Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme / të palujtshme apo të drejta )

Ortaket përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë ;

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.



## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Assambleja e ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë. Assambleja e ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Assambleja e ortakeve vendos për çështje si :

- a) Percaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Perfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

Të gjitha vendimet e marra nga Assambleja e ortakeve regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirebesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në baze të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë "**LA CAFFETTERIA**" shpk, caktohet jashtë ortakerisë, Z. Erion Sedja, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Assambleja e ortakeve të shoqërisë.



## Neni 10

### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqrise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercejne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqrise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asmbleses se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqrise tregetare. Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetëve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret , si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejt te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shoqerine perpara te gjithë personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te Shoqerise.

Administratoret angazhojn Shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e Shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.



## Neni 11

### Viti Financiar

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor

## Neni 12

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakeve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimi
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te Gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

## Neni 13

### Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise

## Neni 14

### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ( kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti I mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Serxhio Mezi

